

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 66/2021

Datë: 28.10.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

V E N D I M

mbi

caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e të masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive të Pakos së Ringjalljes Ekonomike

I. BIZNESET PRODHUESE DHE PËRPUNUESE

A. Forma e Subvencionimit

1. Subvencionimi i kredisë investive, bëhet në formën si në vijim:

1.1. Subvencionimi prej 20% (njëzetë për qind) të kredive investive, deri në maksimum 400,000.00 € (katërqind mijë euro), duke filluar nga data 1 Tetor 2021.

B. Kriteret për Subvencionim

2. Subvencionimi sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për bizneset që i plotësojnë kriteret në vijim:

- 2.1. Veprimtaria e biznesit bie në kategorinë prodhuese dhe/apo përpunuese;
 - 2.2. Qëllimi i marrjes së kredisë është zgjerimi i kapaciteteve të biznesit; dhe
 - 2.3. Së paku 50% (pesëdhjetë për qind) e mjeteve financiare të kredisë duhet të investohen në pajisje dhe mjete të punës që ndërlidhen me procesin e prodhimit dhe/apo të përpunimit të produkteve, kurse pjesa tjetër mund të shpenzohet për investime tjera që ndërlidhen me rritjen e kapaciteteve prodhuese/përpunuese.
3. Kriteret e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

C. Kufizimet në Subvencionim

4. Mjetet financiare nga kredia nuk mund të shfrytëzohen për blerjen e paluajtshmërive dhe/apo investimeve të tjera që nuk ndërlidhen me procesin e prodhimit dhe/apo përpunimit të produkteve.

D. Disbursimi i Subvencionimit

5. Disbursimi i subvencionimit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet pas plotësimit të kritereve të përcaktuara në pikën 2 dhe 4 të këtij vendimi, në formën si në vijim:
- 5.1. 15 % (pesëmbëdhjetë për qind) e vlerës totale të kredisë do të subvencionohet me rastin e disbursimit të së paku 70 % (shtatëdhjetë për qind) të kredisë; dhe
 - 5.2. 5 % (pesë për qind) e vlerës totale të kredisë do të subvencionohet në rastin kur biznesi ka paguar po të njëjtën vlerë të mjeteve financiare për paga për të punësuarit e rinj.

II. BIZNESET NË PRONËSI TË GRAVE

E. Forma e Subvencionimit

6. Subvencionimi i kredisë investive, bëhet në formën si në vijim:
- 6.1. Subvencionimi prej 20% (njëzetë për qind) të kredive investive, deri në maksimum 400,000.00 € (katërqind mijë euro), duke filluar nga data 1 Tetor 2021.

F. Kriteret për Subvencionim

7. Subvencionimi sipas pikës 6 të këtij vendimi bëhet për të gjitha bizneset që janë në pronësi të grave dhe/apo bizneset në të cilat gratë kanë shumicën e pronësisë dhe plotësojnë kriteret si në vijim:

- 7.1. Veprimtaria e biznesit duhet të jetë në linjë me prioritetet e Qeverisë;
- 7.2. Qëllimi i marrjes së kredisë është zgjerimi i kapaciteteve të biznesit; dhe
- 7.3. Së paku 50% (pesëdhjetë për qind) e mjeteve financiare të kredisë duhet të investohen në pajisje dhe mjete të punës që ndërlidhen me aktivitetin e biznesit.

8. Kriteret e përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

G. Kufizimet në Subvencionim

9. Mjetet financiare nga kredia nuk mund të shfrytëzohen për blerjen e paluajtshmërive dhe/apo investimeve që nuk ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve të biznesit.

H. Disbursimi i Subvencionimit

10. Disbursimi i subvencionimit sipas pikës 6 të këtij vendimi do të bëhet pas plotësimit të kritereve të përcaktuara në pikat 7 dhe 9 të këtij vendimi, në formën si në vijim:

- 10.1. 15 % (pesëmbëdhjetë për qind) e vlerës totale të kredisë do të subvencionohet me rastin e disbursimit të së paku 70 % (shtatëdhjetë për qind) të kredisë; dhe
- 10.2. 5 % (pesë për qind) e vlerës totale të kredisë do të subvencionohet në rastin kur biznesi ka paguar po të njëjtën vlerë të mjeteve financiare për paga për të punësuarit e rinj.

III. BIZNESET TJERA

I. Forma e Subvencionimit

11. Subvencionimi i kredive për likuiditet, bëhet në formën si në vijim:

- 11.1. Subvencionimi prej 10% (dhjetë për qind) të kredive për likuiditet, deri në maksimum 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), por jo më shumë se 300 € (treqind euro) për punëtor aktual, duke filluar nga data 1 Tetor 2021.

J. Kriteret për Subvencionim

12. Subvencionimi sipas pikës 11 të këtij vendimi bëhet për të gjitha bizneset që plotësojnë kriteret si në vijim:

- 12.1. Të gjitha bizneset që kanë nevojë për likuiditet për të vazhduar operimin dhe për t'i mbajtur punëtorët në punë.

IV. FORMA E APLIKIMIT

13. Aplikimi bëhet nga biznesi përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI.
14. Aplikimi për të përfituar nga masa 2.1 për bizneset prodhuese dhe/apo përpunuese, dhe për bizneset në pronësi të grave, bëhet në tri faza:
 - 14.1. Faza e parë e aplikimit bëhet për miratimin paraprak të planit investiv, qëllimit si dhe shumës së kredisë investive nga ana e Komisionit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 14.2. Faza e dytë e aplikimit, për subvencionimin prej 15 % (pesëmbëdhjetë për qind) të vlerës totale të kredisë, bëhet në momentin e disbursimit të 70 % të mjeteve financiare nga kredia investive; dhe
 - 14.3. Faza e tretë e aplikimit, për subvencionimin prej 5 % (pesë për qind) të vlerës totale të kredisë, bëhet në rastin kur përfituesi/ja ka paguar po të njëjtën vlerë të mjeteve financiare për paga për të punësuarit e rinj.
15. Aplikimi për të përfituar nga masa 2.1 për kreditë për likuiditet bëhet përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në sistemin elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës.
16. Aplikimi mbetet i hapur deri me datën 30 Qershor 2022, dhe/ose për aq kohë sa ekziston hapësira fiskale për zbatimin e masës.

V. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËRFITUESVE

17. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes një vendimi të veçantë, themelon një Komision në kuadër të Ministrisë për aprovimin e listës së përfituesve.
18. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga subvencionimi sipas këtij vendimi konfirmohet nga Komisioni i përcaktuar në pikën 17 të këtij vendimit.
19. Lista finale me të dhënat e përfituesve dhe shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës procedohet tek Thesari për ekzekutim.

K. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM


20. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogaritë bankare të përfituesve.

21. Oblígohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

L. HYRJA NË FUQI

22. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hekuran Murati


Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi i'u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; dhe
- Arkivit të MFPT-së.